FUTBOLLI PËR KOMBIN

2022-2025

http://fshf.org

FUTBOLLI PËR KOMBIN

2022 - 2025

GRASSROOTS

EDUKIMI

KOMPETICIONET KOMBËTARE

EKIPET KOMBËTARE

INFRASTRUKTURA

FUTBOLLI I FEMRAVE

QEVERISJA E MIRË

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

FUTBOLLI PËR KOMBIN

2022-2025

PARATHËNIE

Të dashur miq,

Të shkruash e të flasësh për futbollin në Shqipëri bëhet gjithnjë e më e bukur, aq sa të krijon emocione të veçanta e tërësisht të gjalla e, ndoshta, të vështira ndonjëherë për t'u shprehur. Realiteti i këtij sporti në vendin tonë është krejt ndryshe nga ç'kishim konceptuar dikur në kokën tonë, me ëndrra që i mendonim, me dëshirën e shpresën e madhe që një ditë të largët t'i realizonim, pa e ditur se KUR, por duke luftuar dhe punuar çdo orë e ditë për mënyrën se SI.

Asgjë nuk është e thjeshtë, në fakt. As nuk ishte, as nuk është, e sigurisht as nuk do të jetë. Por kurrsesi nuk mund të mohojmë një të vërtetë të madhe, që ka prekur dhe ka ndryshuar rrënjësisht lojën tonë të bukur, atë sport pas të cilit "çmendemi" të gjithë, futbollit, që tashmë është pjesë e historisë së vendit tonë. Dekada e fundit, pa dyshim, do të mbahet mend nga të gjithë, jo vetëm nga adhuruesit e futbollit, por edhe nga ata që shumë pak e ndjekin futbollin.

Kemi pasur fatin e madh të jemi dëshmitarë të rritjes që ka njohur ky sport dhe duhet të jemi të vetëdijshëm se ngritja ka ardhur falë një pune shumëvjeçare për ta parë futbollin shqiptar, e kryesisht skuadrat shqiptare dhe ekipet kombëtare të lakohen për arritjet e tyre jo vetëm në zyrat e qeverive të futbollit europian e botëror, por edhe në mediat më prestigjioze në botë, që sigurisht sjell gëzim, por nga ana tjetër edhe më shumë detyrim për t'u përkushtuar e për të punuar më fort, për të arritur edhe më shumë gjëra të bukura dhe për ta çuar edhe më lart emrin e Shqipërisë në botë.

Roli ynë nuk ka qenë i thjeshtë, por skuadra e Federatës Shqiptare të Futbollit ka bërë një punë shumë të mirë përgjatë këtyre viteve. Asgjë nuk është perfekte, madje do të gënjenim nëse do të thoshim që perfeksionin e kemi arritur vetëm ne apo që do ta arrijmë vetëm ne. Kanë ndodhur edhe gabime, për të cilat jemi të ndërgjegjshëm dhe kemi punuar që t'i përmirësojmë. Dhe ndoshta më mirë që kanë ndodhur, pasi kemi mësuar prej tyre. Por ne jemi të lumtur e krenarë që kemi pasur një rol kyç në rritjen e nivelit të këtij sporti, që sipas statistikave është më i pëlqyeri në vendin tonë të dashur e të vogël. Sigurisht, mundësitë janë për shumë e më shumë dhe pikërisht për të arritur këtë "shumë", për t'u siguruar futbolldashësve tanë, numri i të cilëve rritet ditë pas dite, mundësi më të mira, dokumenti i mëposhtëm paraqet dhe prezanton strategjinë për katër vitet në vijim, për një futboll që i shërben kombit.

E ardhmja e një kombi janë fëmijët. Pa dyshim, edhe në futboll është e njëjta logjikë. Pa ta, futbolli do të vdiste, ashtu sikurse kombi. Prandaj, fokusi kryesor në planin tonë për zhvillimin e futbollit për katër vitet e ardhshme, do të jetë rritja e numrit të fëmijëve që luajnë futboll dhe përfshirja e tyre në këtë sport, duke pasur parasysh rritjen e cilësisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të kompeticioneve të fëmijëve tanë, si dhe përmirësimin e infrastrukturës, që së fundmi po merr vëmendjen tonë të veçantë, me fusha të reja dhe me një projekt të lançuar prej kohësh, "100 Fusha", që ka nisur tashmë të aplikohet në disa zona.

Jemi të vetëdijshëm që futbolli është sporti më i ndjekur në Shqipëri, si dhe më i dashuri, pas të cilit lidhemi edhe emocionalisht, teksa shohim se si të gjithë brohorasim e lumturohemi me ditë kur fitojnë skuadrat tona të zemrës, apo mërzitemi kur nuk marrim rezultatet e duhura. Për këtë arsye, duke parë se futbolli jo vetëm që ndiqet me kërshëri, por edhe luhet në masë, ne do të veprojmë me përgjegjësi dhe integritet të plotë, do të përpiqemi për më shumë, do të jemi më afër çdo fëmije, vajzë apo djalë, futbollisti, femër apo mashkull, trajneri apo trajnereje, stafi të çdo ekipi, akademie, klubi, e sigurisht tifozi, që është lojtari i 12-të i çdo skuadre, duke ia bërë rrugën më të lehtë, pa peripeci që shpesh të detyrojnë të mbetesh në gjysmë. Pikërisht kjo është ajo që ofron "Futbolli për kombin", futbollin për të gjithë, pa asnjë dallim, me më shumë lehtësi dhe me më shumë mundësi për të luajtur.

Kemi pasur arritje të mëdha, për të cilat jemi ndier të gjithë krenarë. Madje pas kualifikimit në finalet e Kampionatit Europian 2016, të gjithë ndiheshim krenarë që ishim shqiptarë, teksa ndodh shpesh të themi të kundërtën. Dhe, në fakt, nuk është pak të jesh pjesë e një kampionati të tillë, që dëshirohet nga çdo përfaqësuese. Ne e arritëm, pasi dhuruam jo vetëm lojë të bukur, por morëm rezultate dhe treguam në Francë se edhe pse një vend i vogël, edhe ne dimë të luajmë futboll të bukur. Kjo aventurë e bukur u pasua me vendimin për të ndërtuar shtëpinë tonë të re, për të cilën kishim vërtet nevojë. "Air Albania", që sot është shtëpia e të gjithë shqiptarëve, u ndërtua për kombëtaren shqiptare e jo vetëm, për të gjithë tifozët tanë, për të arritur e festuar sukseset tona më të mëdha. E, ç'është e vërteta, në këtë stadium kemi arritur të prekim një sukses, kalimin nga Liga C në Ligën B në Nations League, por për fat të keq pa lojtarin tonë të 12-të, për shkak të pandemisë globale.

Dikur, ideja se futbolli mund të luhej nga femrat, ishte tabu për shumëkënd. Madje edhe në qytetet e zhvilluara të vendit, pak flitej për futboll femrash e pak vajza e zhvillonin këtë lojë. Ndërsa sot jemi në një realitet krejt ndryshe. Me një ekip kombëtar që është në zhvillim e sipër, me ekipet zinxhir që po punojnë për të sjellë elementë të rinj, me skuadra femrash në disa qytete kryesore të Shqipërisë, prioriteti ynë është më se i qartë: më tepër femra në fushat e blerta. Për këtë arsye, "Futbolli për kombin 2025" do të jetë në mbështetje të plotë të strategjisë së ndërtuar nga Federata e Futbollit për rritjen e futbollit të femrave dhe përmirësimin e cilësisë së tij.

Futbolli është një formë katalizatori, që na lidh ne me të gjithë, jo vetëm me pushtetin vendor e atë qendror, jo vetëm me skuadrat e futbollistët, jo vetëm me amatorët e tifozët, por edhe me vendet jashtë Shqipërisë, me partnerët tanë. Pikërisht për këtë arsye, një tjetër synim i kësaj strategjie do të jetë edhe forcimi i mëtejshëm i këtyre marrëdhënieve, përmes të cilave do të luftojmë për ta zhvilluar më tej futbollin tonë.

Kapitujt e rinj janë gjithmonë interesantë, sjellin gjëra të reja e pa diskutim tunduese, ashtu sikurse do të sjellë "Futbolli për kombin 2025" për lojën tonë të dashur. Duke ju uruar më të mirat në të gjitha përpjekjet tuaja personale në futboll si pjesë e këtij rrugëtimi, dëshiroj ta mbyll me një shprehje të një prej oratorëve më të mëdhenj grekë, Demostenit, i cili thotë: "Fjalët që nuk ndiqen nga veprat, nuk vlejnë asgjë." Përmes kësaj strategjie, ne synojmë të tregojmë veprat tona, të cilat nuk do të kenë nevojë për fjalë.

ARMAND DUKA
PRESIDENT I FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT

PËRMBAJTJA

HYRJE 5
RRUGËTIMI I FSHF-së DERI MË SOT 7
QËLLIMI I FSHF-së 11
NDËRTIMI I NJË FSHF-je TË FORTË 13
PASQYRA E STRATEGJISË 15
GRASSROOTS 17
EDUKIMI 25
KOMPETICIONET KOMBËTARE 28
EKIPET KOMBËTARE 35
INFRASTRUKTURA 41
FUTBOLLI I FEMRAVE 47
QEVERISJA E MIRË 53
MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN 59
PËRGJEGJËSIA SOCIALE 65
PËRMBYLLJE 71

HYRJE

THEMELUAR MË 6 QERSHOR 1930, FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT KA PASUR PËRGJEGJËSINË E VETME PËR ZHVILLIMIN, ORGANIZIMIN DHE QEVERISJEN E FUTBOLLLIT NË TË GJITHË SHQIPËRINË. SA U PËRKET PERFORMANCAVE NË NIVEL KOMBËTAR DHE PJESËMARRJES NË TË GJITHA NIVELET E LOJËS, SË BASHKU SI KOMB KEMI ARRITUR SUKSESE MBRESËLËNËSE NË VITET E FUNDIT DHE JEMI ENTUZIASTË QË DO T'I ÇOJMË MË TEJ KËTO SUKSESE PËRMES STRATEGJISË SONË TË RE: "FUTBOLLI PËR KOMBIN 2025".

"Futbolli për kombin 2025" është një dokument që ka si qëllim të udhëzojë të gjithë aktorët tanë të futbollit, qofshin aktorë të brendshëm të FSHF-së apo të jashtëm, që jo vetëm të përpiqen për të arritur një sukses më të madh në të gjithë vendin, por edhe një përfshirje më të gjerë e risi më të mëdha në punën që bëjnë. Fokusi kryesor i punës sonë do të jenë fëmijët dhe të rinjtë, si e ardhmja e kombit dhe e futbollit, por në të njëjtën kohë do të ndajmë përvojën pozitive të futbollit me të gjithë qytetarët dhe do t'u ofrojmë atyre mundësinë për t'u angazhuar në futboll.

Si anëtarë të FIFA-s që prej vitit 1932 si dhe anëtarë themelues të UEFA-s që prej vitit 1954, ne e konsiderojmë veten me fat që kemi një rrjet të gjerë mbështetjeje ndërkombëtare, që është pa dyshim një ndihmë e paçmueshme për të arritur synimet dhe objektivat tona. Si pjesë e këtij rrjeti, ne dëshirojmë të falënderojmë këto struktura për mbështetjen e vazhdueshme që kanë dhënë për zhvillimin e futbollit. Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin teksa synojmë ta sjellim në jetë këtë dokument.

Për të arritur objektivat tona, është e rëndësishme që qytetarët dhe palët e interesuara të kuptojnë se roli ynë si organ drejtues i futbollit në Shqipëri shkon përtej performancave të ekipit kombëtar dhe organizimit të të gjitha klubeve tona profesionale. Që prej sigurimit të statusit si organizatë jofitimprurëse në vitin 1999, FSHF është krenare për pozicionin e saj në shoqërinë shqiptare si një katalizator për ndryshim, duke luajtur një rol mbështetës për këtë sport, që ka evoluar natyrshëm ndër vite. FSHF beson se mund të ketë një rol të rëndësishëm në bashkimin e kombit, me anëtarët e komunitetit të gjerë sportiv, për të krijuar një mjedis të njohur ndërkombëtarisht për futbollin shqiptar – duke ofruar një gamë të gjerë mundësish zhvillimi shoqëror përgjatë këtij procesi. Ne ofrojmë platformën për t'u angazhuar në futboll në të gjitha nivelet e lojës, si lojtar, trajner, zyrtar apo spektator. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për një platformë të konceptuar për kënaqësi, zhvillim apo konkurrencë, ne do të punojmë për të përmbushur nevojat e çdo individi që tregon interes për futbollin.

Në përpjekje për të përmbushur këto nevoja gjatë katër viteve të ardhshme, "Futbolli për kombin 2025" do të përbëhet nga nëntë fusha, që janë listuar më poshtë:

- **GRASSROOTS**
- **EDUKIMI**
- **KOMPETICIONET KOMBËTARE**
- **EKIPET KOMBËTARE**
- **INFRASTRUKTURA**
- **FUTBOLLI I FEMRAVE**
- **QEVERISJA E MIRË**
- **MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN**
- **PËRGJEGJËSIA SOCIALE**

RRUGËTIMI I FSHF-së DERI MË SOT



1930

Themelimi i Federatës Shqiptare të Futbollit

1932

Anëtarësimi në FIFA

1946

Kampion të Ballkanit

1954

FSHF, anëtare themeluese e UEFA

1963

Pjesëmarrja e parë zyrtare në Eliminatoret e Kampionatit Europian

1965

Pjesëmarrja e parë zyrtare në Eliminatoret e Kupës së Botës

PËRGJATË KËTYRE 90 VITEVE, KA PASUR SHUMË MOMENTE KYÇE QË NA KANË RRITUR DASHURINË PËR FUTBOLLIN DUKE NA KTHYER NË NJË KOMB FUTBOLLDASHËS. NDËRSA SHIKOJMË PËRPARA DREJT KATËR VITEVE TË ARDHSHME, RIKUJTIMI I KËTYRE MOMENTEVE KULMORE, TË CILAT JANË PJESË E RRUGËTIMIT TONË, DO TË NA MOTIVOJË PËR TË HEDHUR GURË TË FORTË THEMELI DREJT PËRVJETORIT TË 100-TË, QË DO TË JETË PJESË E PERIUDHËS TJETËR STRATEGJIKE.

'73-'80

Mospjesëmarrje në asnjë kompeticion ndërkombëtar (Shqipëria tërhiqet nga të gjitha garat gjatë kësaj periudhë, që përkon me periudhën më të rreptë të komunizmit në vend)

'91-'93

Emigracioni masiv i Shqiptarëve drejt Europës, mes të cilëve dhe i shumë futbollistëve

2002

Fillimi i investimeve në infrastrukturën sportive

2016

Pjesëmarrja për herë të parë në finalet e Kampionatit Europian - Euro 2016, dhe renditja më e lartë e arritur ndonjëherë

2019

Zgjedhja e Presidentit të FSHF-së si anëtar i Komiteti Ekzekutiv të UEFA

2022

Prezantimi dhe nisja e implementimit të strategjisë 'Futbolli për Kombin 2022-2025'

RRUGËTIMI I FSHF-së DERI MË SOT

LOJTARËT

LOJTARËVE
TË REGJISTRUAR

LOJTARË MESHKUJ
94%

LOJTARE FEMRA
6%





LOJTARËVE NË GARAT
KOMBËTARE

LOJTARË MESHKUJ
92%

LOJTARE FEMRA
8%



LOJTARËVE NË
GARAT RAJONALE

LOJTARË MESHKUJ
96%

LOJTARE FEMRA
4%

STATISTIKAT E SHQIPËRISË

POPULLSIA
2.84 MILLION

SIPËRFAQE
28,748KM²

STADIUMET
34

STAFI I FEDERATËS
112

TRAJNERËT

TOTALI
1,815

LICENSA PRO	LICENSA A	LICENSA B	LICENSA C	LICENSA D
TOTALI 132	TOTALI 405	TOTALI 1038	TOTALI 110	TOTALI 230
MESHKUJ 131	MESHKUJ 403	MESHKUJ 992		
FEMRA 1	FEMRA 2	FEMRA 46		

RRJETET SOCIALE

191.7 PËLQIMET

101.4 K NDJEKËSIT

17.5 K NDJEKËSIT

11.4 K PAJTIMTARË

KLUBET

10 KATEGORIA SUPERIORE

16 KLUBET E KATEGORISË SË PARË

24 KLUBET AMATORE TË KATEGORISË SË 2-TË

QËLLIMI I FSHF-së

VIZIONI

Të jetë një forcë shtytëse pozitive në hapësirën sportive dhe sociale në mbarë Shqipërinë, duke përdorur futbollin për të rritur potencialin

MISIONI

Të forcojë lojën e futbollit dhe të promovojë vlerat e tij në të gjithë popullsinë shqiptare, për të përmirësuar jo vetëm paraqitjet tona në fushë, por edhe cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët

VLERAT

Besimi
Profesionalizmi
Respekti
Pasioni
Unifikimi
Progresi

NDËRTIMI I NJË FSHF-je TË FORTË

ME LANÇIMIN E STRATEGJISË "FUTBOLLI PËR KOMBIN 2025", NE KEMI VENDOSUR PIKETA TË FORTA PËR TË ARDHMEN, DUKE QENË TË NDËRGJEGJSHËM PËR FUQINË TONË SI ORGANIZATË DHE PËR TË GJITHA MUNDËSITË QË KEMI PËR TË MBËSHTETUR MË TEJ ZHVILLIMIN E FUTBOLLIT NË TË GJITHË SHQIPËRINË.

Objektivat e përcaktuar si pjesë e kësaj strategjie, nuk janë formuluar vetëm nëpërmjet konsultimit të kujdesshëm me aktorët dhe partnerët tanë kryesorë, por edhe përmes një analize të detajuar të faktorëve që do të ndikojnë në punën që kemi përpara, si dhe problemeve që mund të krijohen dhe që ne nuk mund t'i kontrollojmë.

Pandemia e fundit globale ishte një shembull i qartë se si një faktor i pakontrollueshëm ndikoi në mënyrë të pashmangshme në punën dhe planet tona, por mënyra se si FSHF u përshtat me këtë përvojë të re, tregoi se qëllimet dhe objektivat tanë mund të arrihen në mënyra të ndryshme. Nivelet e përkushtimit dhe dëshirës sonë për të arritur objektiva edhe gjatë kësaj periudhe, ofrojnë baza të qëndrueshme për ndërtimin e një FSHF-je më të fortë dhe "Futbolli për kombin 2025" hedh hapin tjetër në këtë drejtim.

Në përputhje me vizionin tonë për të shërbyer si një forcë shtytëse pozitive në botën sportive dhe sociale në të gjithë Shqipërinë, duke përdorur futbollin për të maksimizuar potencialin,

"Futbolli për kombin 2025" do të ketë si synim të vazhdojë:

- Promovimin e një qasjeje të konsoliduar ndaj lidershipit në të gjitha aspektet e FSHF-së
- Zhvillimin e përvojës më të mirë në organizimin e të gjitha aktiviteteve të futbollit në vend
- Ruajtjen e marrëdhënieve të ngushta dhe bashkëpunuese me të gjitha klubet
- Dialogimin e vazhdueshëm me institucionet shtetërore dhe shoqatat tona rajonale për të mbështetur realizimin e objektivave strategjikë
- Ofrimin e mundësive edukative për trajnerët e klubeve për të ruajtur nivelet e larta të cilësisë

Njëkohësisht, ky vizion synon të zhvillojë:

- Infrastrukturën e futbollit në të gjithë vendin
- Lidhjen direkte të klubeve profesioniste dhe amatore me FSHF-në dhe nxitjen e tyre për rritjen e numrit të lojtarëve
- Standardet e nevojshme për klubet private, për të siguruar që të gjithë pjesëmarrësit të marrin përvojën më të mirë të mundshme në futboll
- Mundësitë për t'u angazhuar në futboll pavarësisht nga mosha, gjinia apo situata social-ekonomike
- Rritjen e mëtejshme të klubeve anëtare të Federatës së Futbollit

PASQYRA E STRATEGJISË

VIZIONI

Të shërbejmë si një forcë shtytëse pozitive në botën sportive dhe sociale në mbarë Shqipërinë, duke përdorur futbollin për të rritur potencialin

MISIONI

Të forcojmë lojën e futbollit dhe të promovojmë vlerat e tij në të gjithë popullsinë shqiptare, për të përmirësuar jo vetëm paraqitjet tona në fushë, por edhe cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët

VLERAT

Besimi
Profesionalizmi
Respekti
Pasioni
Unifikimi
Progresi

GRASSROOTS

Për të zhvilluar futbollin e bazës, ne do të ofrojmë mundësi të favorshme, frymëzuese dhe të aksesueshme për të gjithë shqiptarët, për të shijuar e jetuar me lojën e futbollit

Matësi i suksesit: Regjistrimi i 23.000 lojtarëve deri në vitin 2025

EDUKIMI

Për të përmirësuar edukimin, ne do të krijojmë struktura dhe shërbime cilësore arsimore që u sigurojnë trajnerëve, zyrtarëve, gjyqtarëve dhe vullnetarëve tanë rritjen e vazhdueshme të aftësive, përvojës dhe performancës së tyre

Matësi i suksesit: Dyfishimi i numrit të trajnerëve të licencuar deri në vitin 2025

KOMPETICIONET KOMBËTARE

Për të zhvilluar programin tonë kombëtar të garave, ne do të përqendrohemi si në rritjen e cilësisë, ashtu edhe në prezantimin e risive

Matësi i suksesit: Shpalosja e "Strategjisë për mbështetjen e klubeve" deri në vitin 2022

EKIPET KOMBËTARE

Për të zhvilluar ekipet tona kombëtare, ne do të nxisim dhe do të mbështesim rritjen e talenteve, ndërkohë që në fushë do të japim paraqitje që do ta bëjnë Shqipërinë krenare

Matësi i suksesit: Kualifikimi në Kampionatin Europian të vitit 2024

INFRASTRUKTURA

Për të zhvilluar infrastrukturën tonë të futbollit, ne do të investojmë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e fushave dhe objekteve sportive nga baza në elitë

Matësi i suksesit: Ndërtimi i 100 fushave të reja me bar natyral deri në vitin 2025

FUTBOLLI I FEMRAVE

Për të zhvilluar futbollin e femrave, ne do të krijojmë ambiente favorizuese dhe të aksesueshme, ku gratë dhe vajzat të mund të shijojnë futbollin dhe të përmbushin potencialin e tyre

Matësi i suksesit :

Regjistrimi 4000+ lojtaresh femra deri në vitin 2025

QEVERISJA E MIRË

Për të siguruar qeverisje të mirë në çdo gjë që bëjmë, ne do të përpiqemi vazhdimisht të jemi në krye të praktikave më të mira ndërkombëtare në qeverisjen sportive

Matësi i suksesit: Nisja e "Strategjisë së qeverisjes së mirë të FSHF-së" deri në vitin 2022

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Për të përmirësuar marrëdhëniet tona me publikun, ne do të përshtatemi dhe do të sigurojmë që FSHF të jetë burim informacioni dhe transparence për të gjithë .

Matësi i suksesit: Një plan vjetor gjithëpërfshirës për menaxhimin e të gjithë aktorëve të përfshirë, për të siguruar që FSHF të ofrojë shërbimin e mbështetjen më të mirë për familjen e saj të madhe të futbollit

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Për t'u siguruar që do t'i shtojmë vlera pozitive shoqërisë, ne do të përdorim fuqinë e futbollit për të përmirësuar cilësinë e jetës së njerëzve

Matësi i suksesit: Krijimi i Fondacionit FSHF deri në vitin 2023, për të promovuar aktivitetin me karakter social dhe për të qenë afër shtresave të margjinalizuara në të gjithë vendin

GRASSROOTS

PAVARËSISHT NGA FORMATI, AFTËSITË APO GJINIA, FUTBOLLI I BAZËS PËRQENDROHET NË PËRKUSHTIMIN TONË PËR TË PËRFSHIRË SA MË SHUMË NJERËZ NË FUTBOLLIN AMATOR DHE KRIJIMIN E NJË MJEDISI SA MË TËRHEQËS DHE TË SHËNDETSHËM.

GRASSROOTS

PËRMBAJTJA

Historikisht, futbolli bazë në Shqipëri është organizuar në mënyrë shumë spontane dhe të pastrukturuar. Me kalimin e viteve, për ta bërë më të lehtë angazhimin në futboll, FSHF ka udhëhequr zhvillimin dhe zbatimin me sukses të një sërë praktikash, duke zhvilluar aktivitetin, ligat dhe klubet. Tashmë që këto struktura janë të sistemuara, synimi ynë është që qytetarët tanë të kenë një gamë të qartë mundësish për të marrë pjesë dhe për të shijuar futbollin, që nga vitet e shkollës fillore deri në nivelet më të larta. Për të zhvilluar talentet më të spikatura të futbollit, në të gjithë Shqipërinë janë krijuar kushte progresive për t'u ofruar mundësitë e nevojshme këtyre talenteve që të shpalosin dhe të përmirësojnë potencialin e tyre.

Pavarësisht nga zhvillimi i suksesshëm i këtyre strukturave, jo të gjithë personat që luajnë futboll sot në vend, janë pjesë e një gare të organizuar. Si organi drejtues i futbollit në të gjithë Shqipërinë, është detyra jonë të sigurojmë që aktivitetet që zhvillohen jashtë juridiksionit të FSHF-së, siç janë ato që ofrohen nga klube private ose përmes formateve të tjera, si futsalli, të regjistrohen brenda kompeticioneve amatore ose profesioniste që organizon Federata e Futbollit.

Të gjitha kushtet e pjesëmarrjes duhet të jenë të standardit më të lartë të mundshëm. Ata që janë të përfshirë në këtë strukturë të madhe, të jenë të arsimuar dhe të kuptojnë rëndësinë e përmbushjes së standardeve. Si anëtarë të Kartës së UEFA Grassroots, përpjekjet tona nuk do të fokusohen vetëm në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në futboll, por edhe në mbështetjen e atyre që tashmë e luajnë lojën më të dashur të shqiptarëve.

Në misionin tonë për ta arritur këtë, FSHF do të punojë ngushtë me aktorët e të gjitha niveleve dhe në të gjitha kategoritë e lojës, pasi arritja e suksesit si forcë kolektive do të jetë e vetmja mënyrë për të gjeneruar nivelin e dëshiruar të ndikimit.

Si pjesë e kësaj force kolektive, kontakti me ish-lojtarë, prindër dhe mësues shkollash për t'i bërë bashkë në përpjekjet tona për realizimin e këtyre aspiratave, do të përmirësojë jo vetëm përvojën e futbollit në mbarë Shqipërinë, por edhe jetën e përditshme në të gjithë shoqërinë, me vlerat që do të përpiqemi të rrënjosim përmes futbollit.

Duke marrë në konsideratë lidhjet dhe vizionin tonë për të ardhmen, ofrimi i programeve dhe mundësive për të luajtur brenda shkollave anembanë vendin, si private ashtu edhe publike, do të jetë çelësi për arritjen e suksesit të grassroots. Krijimi i lidhjeve efektive midis shkollave dhe klubeve do të jetë gjithashtu i rëndësishëm për të ofruar platformën e nevojshme për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm.

*TË DHËNAT E QERSHORIT 2021

GARAT RAJONALE

FEMRA

MESHKUJ



TOTAL I LOJTARËVE TË REGJISTRUAR NË SHQIPËRI

FEMRA

MESHKUJ



GRASSROOTS

PËR ZHVILLIMIN E FUTBOLLIT GRASSROOTS, NE DO TË VAZHDOJMË TË OFROJMË MUNDËSI FAVORIZUESE, FRYMËZUESE DHE TË AKSESUESHMEPËR TË GJITHË FËMIJËT E PËR TË GJITHË SHQIPTARËT QË DUAN TË LUAJNË FUTBOLL.

KËTË DO TA ARRIJMË PËRMES PËRMBUSHJES SË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË MËPOSHTME:

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
Rritja e numrit të personave që luajnë futboll në gjithë Shqipërinë	• Regjistrimi i 23.000 lojtarëve deri më 2025
Frymëzimi i brezave të rinj për t'u futur në botën e bukur të futbollit	• Rritja me 10% e numrit të nxënësve të shkollave që regjistrohen në kampionatet e organizuara nga FSHF
Përmirësimi i standardeve dhe aftësive të trajnerëve që punojnë me futbollin e bazës përmes zhvillimit të metodave gjithëpërfshirëse	• Dyfishimi i numrit të trajnerëve të licencuar në FSHF deri më 2025
Ofrimi i mundësive të reja dhe novatore për të pasur një plan zhvillimi kombëtar, duke i siguruar çdo lojtari mundësinë për t'u zhvilluar dhe për të përmbushur potencialin e vet	• Rritja e investimeve për pjesëmarrjen në futbollin e bazës deri më 2025 • Fillimi i shkollës së futbollit FSHF deri më 2023 • Krijimi i lidhjes së skuadrave të shkollave në ekipet e Superiores deri më 2025

EDUKIMI

RRITJA E MËTEJSHME PROFESIONALE E PUNONJËSVE DHE VULLNETARËVE TANË, QOFSHIN KËTA STAF, TRAJNERË APO ZYRTARË, PËR TË LUAJTUR NJË ROL SA MË EFEKTIV NË PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT PËR TË GJITHË LOJTARËT TANË.

EDUKIMI

PËRMBAJTJA

Për të hedhur baza të sigurta për suksesin e së ardhmes, FSHF është e vetëdijshme se mundësitë e ofruara për edukim dhe zhvillim duhet të jenë më të mëdha se ato që u ofrohen aktualisht individëve në trajnim, pasi bota e futbollit tanimë shtrihet përtej fushëveprimit të dikurshëm. Në vitet e mëparshme mund të kemi pasur vetëm lojtarë, trajnerë dhe zyrtarë që përfshiheshin në fushën e edukimit, por tani mirëpresim individë nga një sërë disiplinash si mjekësia, marketingu dhe marrëdhëniet me publikun, sa për të përmendur disa. Për të krijuar mjedisin më të mirë të mundshëm të futbollit, është detyra jonë që jo vetëm të përmirësojmë aktivitetet tona edukative me ata të cilët punojmë aktualisht, por gjithashtu të ofrojmë mundësi zhvillimi për disiplina të reja, që mund të kontribuojnë në rritjen e lojës sonë.

Duke pasur parasysh këtë, edukimi i stafit teknik dhe zyrtarëve të ndeshjeve nga FSHF do të vijojë të jetë në përputhje me kurrikulat e miratuara nga Konventa e Arbitrazhit dhe Konventa e Trajnerëve, të certifikuara nga IFAB dhe UEFA. Si pjesë e kësaj qasjeje, Akademia jonë e Arbitrimit, e formuar në vitin 2017, do të vazhdojë të ofrojë kualifikimin për arbitrat e rinj në mbarë vendin - duke luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin, promovimin dhe mbrojtjen e cilësisë dhe integritetit të lojës. Gjatë gjithë kësaj periudhe të zhvillimit strategjik, ne synojmë ta kthejmë selinë e FSHF-së, Shtëpinë e Futbollit, në një qendër kombëtare për zhvillimin arsimor me mundësitë që ofrojmë.

Si pjesë e rrjetit të FSHF-së, ne ndihemi të privilegjuar që kemi një gamë kaq të gjerë trajnerësh, që zotërojnë jo vetëm kualifikime të ndryshme, por edhe eksperienca personale të larmishme, gjë që ofron një formim të paçmuar për të gjithë lojtarët tanë. Për ta zhvilluar dhe diversifikuar edhe më tej këtë formim, FSHF, përmes "Futbollit për Kombin 2022-2025", do të synojë të rrisë numrin e trajnerëve të licencuar, trajnerëve për pozicione specifike, si dhe numrin e trajnereve femra në të gjitha nivelet e licencës dhe t'i nxisë ato që të marrin pozicione të rëndësishme në klube.

Shkëmbimi i praktikave më të mira dhe shkëmbimi i njohurive do të jetë çelësi i suksesit në sektorin e edukimit si pjesë e "Futbollit për Kombin 2022-2025". Për ta arritur këtë, FSHF do të ketë një qasje relativisht të re ndaj edukimit në të gjithë futbollin, duke bashkëpunuar me universitetet dhe duke lehtësuar zhvillimin e rrjeteve profesionale për të lidhur të gjitha aspektet e lojës – nga futbolli elitar në atë amator, por edhe lidhjet shkolla-klube, me mësuesit, që janë një komponent gjithnjë e në rritje për sa i përket punës që bëjnë me stërvitjen e të rinjve nëpër shkolla.

Si pjesë e roleve të tyre përkatëse, trajnerët dhe zyrtarët tani janë gjithashtu të ekspozuar ndaj teknologjive të reja si VAR. Duke pasur parasysh këtë fakt, FSHF do të sigurojë që këto risi të përfshihen në proceset e saj arsimore në nivelet e nevojshme, për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre novacioneve.

*TË DHËNAT E QERSHORIT 2021

ARBITRAT E NIVELIT KOMBËTAR

TOTALI
367

ARBITRA MESHKUJ
343

ARBITRE FEMRA
24



TRAJNERËT

TOTALI
1,815

LICENSA PRO
TOTALI
132

MESHKUJ
131

FEMRA
1

LICENSA A
TOTALI
405

MESHKUJ
403

FEMRA
2

LICENSA B
TOTALI
1038

MESHKUJ
992

FEMRA
46

LICENSA C
TOTALI
110

LICENSA D
TOTALI
230

NË KLUBET E KATEGORISË SUPERIORE

8 VIDEO ANALIST

10 TRAJNERË TË FITNESIT

10 MJEKË

10 TRAJNERE PORTIERËSH

EDUKIMI

PËR TË ZHVILLUAR MË TEJ EDUKIMIN SI PJESË THELBËSORE E ZHVILLIMIT, NE DO TË KRIJOJMË STRUKTURA DHE SHËRBIME SA MË CILËSORE PËR TË SIGURUAR QË TRAJNERËT, ZYRTARËT, ARBITRAT DHE VULLNETARËT TANË TË RRISIN VAZHDIMISHT AFTËSITË, PËRFORMANCËN DHE PËRVOJËN E TYRE.

KËTË DO TA ARRIJMË PËRMES PËRMBUSHJES SË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË MËPOSHTME:

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
Krijimi dhe ofrimi i një programi zhvillimi me cilësi të lartë për zyrtarët dhe gjyqtarët, duke nxitur angazhimin e njerëzve të rinj dhe duke lejuar ata që tashmë janë në sistemin tonë të kenë sukses në nivelin më të lartë	• Zhvillimi dhe operimi i strategjisë së arbitrimit deri më 2023 • Rritja me 40% e numrit të gjyqtarëve të kualifikuar përmes Akademisë së Arbitrave • deri në vitin 2025 • Rritja e numrit të gjyqtarëve të licencuar nga FIFA në 20 gjyqtarë deri në vitin 2025
Diversifikimi i network-ut të stërvitjes, duke inkurajuar njerëz nga fusha të ndryshme, që zotërojnë mendime unike dhe përvoja të çmuara, që të përfshihen në stërvitje	• Dyfishimi i numrit total të trajnerëve të licencuar në klube deri në vitin 2025 • Arritja e statusit të nivelit të artë për licencimin Grassroots (femra) deri në vitin 2025
Vendosja e standardeve të larta stërvitore dhe strukturave moderne nëpër klube, duke u siguruar që të përzgjidhen më të talentuarit dhe të krijohet rrjeti i duhur për t'u mundësuar lojtarëve përmbushjen e synimeve të tyre	• Të sigurojmë që trajneri dhe ndihmësi i ekipit të parë të çdo klubi të Kategorisë Superiore të kenë një licencë UEFA Pro deri në vitin 2023 • Të sigurojmë që trajneri i ekipit të parë në të gjitha klubet profesioniste të jetë në nivelin e licencës Pro deri në vitin 2025 • Rritja me 30% e numrit të femrave që përfitojnë licencën UEFA A deri në vitin 2025 • Rritja e numrit të femrave që bëhen trajnere të ekipit të parë në klubet profesionale të të rinjve
Përdorimi i praktikave më të mira novatore për të ndërtuar struktura edukative të nivelit të lartë dhe shërbime për trajnerët, zyrtarët, arbitrat dhe vullnetarët tanë	• Të sigurojmë që të 10 klubet e Kategorisë Superiore të kenë një video-analist, një trajner fitnesi, një mjek dhe një trajner portierësh të licensuar deri në vitin 2025 • Krijimi dhe ofrimi i një programi gjithëpërfshirës të shkencave sportive dhe novacionit teknik deri në vitin 2023 • Ofrimi i bashkëpunimit mes bashkëmoshatarësh përmes një programi konferencash dyvjeçare të edukimit dhe teknologjisë nga viti 2023 • Krijimi i një Biblioteke për Trajningun në FSHF deri në vitin 2023
Krijimi i një rrjeti me ekspertë të jashtëm për të sjellë një frymë të re dhe novatore në mbështetje të programeve edukative të FSHF-së	• Mbajtja e të paktën 2 forumeve novatore në vit me universitetet, qendrat kërkimore dhe federatat e tjera sportive

KOMPETICIONET KOMBËTARE

OFRIMI I NJË STRUKTURE GJITHËPËRFSHIRËSE, KONKURRUESE, ZHVILLIMORE DHE MODERNE PËR TË GJITHË LOJTARËT TANË.

KOMPETICIONET KOMBËTARE

PËRMBAJTJA

Federata Shqiptare e Futbollit është organi i vetëm qeverisës i futbollit në të gjithë Shqipërinë, që ka si qëllim kryesor masivizimin e këtij sporti, duke siguruar të gjithë qytetarët e apasionuar që futbolli është dhe do të mbetet sporti numër një në vend, me të cilin të gjithë mund të angazhohen dhe të kënaqen, qoftë duke luajtur, qoftë duke e ndjekur si spektatorë. Pavarësisht nga niveli i konkurrencës, ne shpresojmë që të gjithë, duke nisur nga lojtarët, të cilët janë protagonistët e ndeshjeve, por edhe trajnerët, zyrtarët e të gjithë spektatorët, të ndihen pjesë e diçkaje të veçantë dhe së bashku të arrijmë suksese të mëdha.

Aktualisht, gara në futbollin shqiptar është e strukturuar në katër nivele: Abissnet Superiore, Kategoria e Parë, Kategoria e Dytë, Kategoria e Tretë.

Katër ekipet që renditen në katër vendet e para në kampionatin e Abissnet Superiore kanë mundësinë të jenë pjesë e Kupave të Europës.

Pavarësisht se ende kërkojmë të zhvillojmë nivelin e cilësisë në këto liga, ne jemi krenarë që shkalla e konkurrencës ka mbetur e lartë, me kampionë të ndryshëm ligash gjatë viteve të fundit, gjë që shpresojmë të vazhdojë edhe gjatë periudhës së ardhshme strategjike. FSHF do të përpiqet ta ruajë dhe ta rrisë më tej shkallën e konkurrencës në nivel elitar duke përdorur mënyra të ndryshme, përfshirë një rishikim dhe filtrim të numrit të klubeve që konkurrojnë në 3 divizionet kryesore. Kampionati i nën 21-vjeçarëve, që ka më shumë se një vit që zhvillohet, do të ofrojë një mundësi më shumë për të rinjtë drejt kalimit në ekipet e para, si dhe do të nxisë rritjen e performancës për skuadrat U-19, U-17 dhe U-15.

Për më tepër, për të rritur kompeticionet kombëtare që rrjedhin nga ky nivel elitar, FSHF do të vazhdojë zhvillimin e Kupës së Shqipërisë dhe Superkupës së Shqipërisë, ndërkohë që do të eksplorojë edhe zhvillimin e kampionateve rajonale si një formë tjetër garash në nivel lokal. Në nivel ndërkombëtar, FSHF është e emocionuar për nisjen e Kupës Nënë Tereza, ku 100 klube nga Shqipëria dhe Kosova do të garojnë për të dalë kampion. Mbështetja për realizimin dhe zbatimin e këtyre kompeticioneve do të kërkojë jo vetëm proceset e zakonshme para ndeshjes, por edhe monitorim dhe kontribut efektiv nga një këndvështrim administrativ pas ndeshjes. Për të promovuar ndeshjet dhe për të menaxhuar çështje si siguria dhe biletat, FSHF do të punojë ngushtë me klubet e saj dhe partnerët e duhur për të siguruar që të ketë nivele maksimale të angazhimit dhe sigurisë në ndeshjet që luhen.

Ne e dimë se cilësia e garës sonë është po aq e rëndësishme sa cilësia e klubeve që konkurrojnë në kampionatet tona. Me këtë synim, stabiliteti dhe qëndrueshmëria do të jenë në qendër të objektivave tona. Ne synojmë të krijojmë strukturën më tërheqëse, konkurruese dhe më zhvillimore që të gjithë lojtarët dhe tifozët tanë të mund të shijojnë kompeticione më cilësore në vitet në vijim.

KUPA E SHQIPËRISË

THEMELUAR NË VITIN 1938

Cdo vit garojnë 32 ekipe

SUPERKUPA E SHQIPËRISË

THEMELUAR NË VITIN 1989

Një ndeshje e vetme zakonisht në fillimi të sezonit ndërmjet fituesit të Kategorisë Superiore dhe Kupës së Shqipërisë

.

ABBISNET SUPERIORE

THEMELUAR NË VITIN 1930

10 EKIPE

9 kampionë të ndryshëm deri më sot, KF Tirana është klubi më i suksesshëm deri më sot
me 25 tituj kampion

KATEGORIA E PARË

THEMELUAR NË VITIN 1930

16 EKIPE

29 kampionë të ndryshëm për datë

KATEGORIA E DYTË

THEMELUAR NË VITIN 1960

24 EKIPE

12 NË GRUPIN A
12 NË GRUPIN B

38 ekipe të ndryshme kampionë deri më sot

KATEGORIA E TRETË

THEMELUAR NË VITIN 2003

6 EKIPE

17 ekipe të ndryshme kampion deri më sot

KOMPETICIONET KOMBËTARE

PËR TË ZHVILLUAR MË TEJ KOMPETICIONET TONA KOMBËTARE, NE DO TË PËRQENDROHEMI NJËHERAZI NË RRITJEN ECILËSISË DHE NË IMPLEMENTIMIN E RISIVE.

KËTË GJË DO TA ARRIJMË PËRMES PËRMBUSHJES SË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË MËPOSHTME:

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
Të mbështesim klubet tona për të funksionuar në mënyrë efektive dhe për të ofruar ndeshje në një mjedis me cilësi të lartë, duke ofruar përvojën më të mirë të mundshme për lojtarët, tifozët dhe partnerët tanë	• Zhvillimi dhe zbatimi i një "Strategjie për mbështetjen e klubeve" deri në vitin 2023 • Të sigurojmë që të gjitha klubet nga 3 kategoritë e para të kenë një drejtor sportiv të licencuar në strukturën e tyre deri në vitin 2025 • Zhvillimi dhe ofrimi i një programi financiar për përmirësimin e infrastrukturës, duke u siguruar që të gjitha stadiumet në Shqipëri të kenë përfituar deri në vitin 2023
Të krijojmë dhe ofrojmë mundësi dhe struktura që klubet tona të konkurrojnë në të gjithë vendin	• Nisja e Kupës Nënë Tereza 2022 me 100 ekipe në Shqipëri dhe Kosovë • Zhvillimi i plotë i ligës U-21 dhe Kategorisë së Parë deri më 2024 • Kryerja e një studimi realizueshmërie për ligën rajonale 2022
Të zhvillojmë strukturat ligjore dhe komerciale që lidhen me konkurrimin	• Të sigurojmë një partner për emërtimin e të gjitha kompeticioneve deri më 2023 • Bashkëpunimi me shtetin për të marrë miratimin e propozimeve ligjore që ndihmojnë në mbarëvajtjen e klubeve

EKIPET KOMBËTARE

EKIPET TONA KOMBËTARE DO TË KËRKOJNË SUKSESIN NË SKENËN NDËRKOMBËTARE, GJITHMONË ME NDJENJËN E UNITETIT DHE TË KRENARISË KOMBËTARE.

EKIPET KOMBËTARE

PËRMBAJTJA

Për dhjetëra mijëra lojtarë anembanë kombit tonë, është një ëndërr që të luajnë futboll me stemën e kombëtares shqiptare, pasi të jenë përzgjedhur për të përfaqësuar vendin, dhe ne ndihemi me fat që kemi mundësinë t'i kthejmë këto ëndrra në realitet. Që nga themelimi ynë në vitin 1930, ka pasur disa ngjarje kryesore të ekipit kombëtar që i kujtojmë me nostalgji, veçanërisht pjesëmarrjen tonë në Kampionatin Europian 2016. Megjithatë, "Futbolli për kombin 2025" synon të hedhë hapa të tjerë përpara dhe të ndërtojë suksese të ardhshme në skenën ndërkombëtare, duke pasur si pikënisje të shkëlqyer suksesin tonë të fundit në Ligën e Kombeve.

Edhe pse fokusi kryesor i opinionit publik është tek ekipi kombëtar A, ne krenohemi shumë me të gjitha skuadrat tona kombëtare, si për meshkuj, ashtu edhe për femra, nga moshat U-15 deri në U-21. Duke filluar procesin e përzgjedhjes nga ekipi kombëtar U-15, ne kemi mundësi të vazhdojmë të zbulojmë dhe të mbështesim sa më shpejt që të jetë e mundur talentet më të mira që kombi ynë mund të ofrojë. Angazhimi ynë në këtë nivel ka bërë të mundur gjithashtu zhvillimin e lidhjeve me futbollin shkollor, që do të na ndihmojë të arrijmë ambiciet tona strategjike për futbollin e bazës. Sa më të forta të jenë këto lidhje, aq më shumë mundësi do të kemi për të zhvilluar talentet tona në mjedisin më të mirë të mundshëm, që do të thotë se më shumë lojtarë cilësorë do të jenë gati për të bërë hapa të mëdhenj përpara, për t'u bërë pjesë e ekipit tonë kombëtar A.

Duke i dhënë një dimension tjetër strukturës sonë, grupmoshat tona U-21, U-19, U-17 dhe U-15 mbështeten gjithashtu nga një ekip kombëtar B. Kjo jo vetëm që rrit shtrirjen tonë në zhvillimin e individëve në këto mosha, por gjithashtu rrit konkurrencën, gjë që nga ana tjetër ka rritur cilësinë e lojës dhe performancave tona.

Si pjesë e "Futbollit për Kombin 2025", ne do të përpiqemi të promovojmë këtë realitet konkurrues në ekipet tona kombëtare, me shpresën se kjo mund të kontribuojë në rritjen e cilësisë si brenda dhe jashtë fushës. Një tjetër fushë ku mund ta promovojmë këtë qasje, janë edhe ekipet tona kombëtare të futsallit, veçanërisht duke synuar krijimin e një ekipi të ri kombëtar futsalli për femra gjatë kësaj periudhe strategjike.

Detyra për zbulimin e talenteve e çon punën tonë përtej kufijve kombëtarë dhe ne jemi me fat që zotërojmë një sistem të gjerë dhe të konsoliduar skautësh, që mbulon pothuajse të gjithë Europën. Ndërkohë që zhvillojmë seanca stërvitore në mënyrë periodike në të gjitha rajonet e vendit për të zbuluar talentet më të mira që jetojnë aktualisht në Shqipëri, ne vëzhgojmë dhe kërkojmë lojtarë të talentuar edhe në vende të tilla si Greqia, Italia, Zvicra, Anglia, Gjermania, Belgjika, Holanda dhe Danimarka. Megjithëse lojtarët mund të konkurrojnë në vende të tjera, ne do të vazhdojmë të marrim dhe të sigurojmë lojtarët më të mirë të mundshëm për ekipet tona kombëtare. Mund të përballemi me sfida në sigurimin e një vendi në kombëtaren A për lojtarët me dy kombësi, megjithatë sa më shpejt që të fillojnë të përfaqësojnë Shqipërinë, aq më të mëdha do të jenë gjasat që këta lojtarë t'i bashkohen FSHF-së.

E lidhur ngushtë me këtë fushë do të jetë puna jonë në edukim dhe infrastrukturë. Ne aspirojmë të krijojmë një mjedis ku ekipet tona kombëtare mbështeten nga stafe me përvojë dhe të aftë në një sërë disiplinash, duke reflektuar një institucion të vlerave më të mira ndërkombëtare.

1946

Kombëtarja Shqiptare fitoi Turneun Ballkanik të Futbollit, duke garuar kundër Jugosllavisë, Bullgarisë dhe Rumanisë. Ekipi Kombëtar u themelua në vitin 1945, dhe ky ishte aktiviteti i parë zyrtar

1978

Kombëtarja U-21 fituese e Kampionatit Ballkanik të Futbollit, duke garuar kundër Jugosllavisë, Bullgarisë, Greqisë, Turqisë dhe Rumanisë

1981

Kombëtarja U-21 fitoi për herë të dytë Kampionatin Ballkanik të Futbollit

1984

Kombëtarja U-21 arriti në çerekfinale të Kampionatit Europian

2016

Pjesëmarrja historike në Kampionatin Europian Euro 2016

NUMRI TOTAL I LOJTARËVE NË TË GJITHA EKIPET KOMBËTARE (A DHE B)

NUMRI TOTAL I EKIPEVE A

RENDITJA AKTUALE E EKIPIT KOMBËTAR A



EKIPET KOMBËTARE

PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË EKIPEVE TONA KOMBËTARE, NE DO TË VIJOJMË TË PROMOVOJMË DHE DO TË MBËSHTESIM TALENTET MË TË MIRA, DUKE DHURUAR NJËKOHËSISHT PERFORMANCA SA MË TË BUKURA TË EKIPEVE TONA KOMBËTARE, PËR TË BËRË KRENAR CDO SHQIPTAR.

KËTË DO TA ARRIJMË PËRMES PËRMBUSHJES SË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË MËPOSHTME:

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
Të dhurojmë në fushë paraqitje që e bëjnë Shqipërinë krenare	• Ruajtja e statusit në Ligën B të UEFA Nations League përgjatë gjithë periudhës strategjike Kualifikimi në Kampionatin Europian 2024 • Meshkuj U-21: Kualifikimi në Kampionatin Europian 2023/24 • Meshkuj U-19: Kualifikimi në raundin elitar të Euro nën 19 vjeç më 2023 dhe përsëritja e kësaj arritjeje të paktën dhe një herë tjetër përgjatë periudhës strategjike • Meshkuj U-17: Kualifikimi në raundin elitar të Euro nën 17 vjeç më 2023 dhe përsëritja e kësaj arritjeje të paktën dhe një herë tjetër përgjatë periudhës strategjike
Evidentimi dhe afrimi i talenteve më të mira si përfaqësues të ekipeve kombëtare dhe afrimi i stafit më të mirë të FSHF-së për t'i mbështetur përgjatë përvojës së tyre në ekipin kombëtar	• Prezantimi dhe implementimi i strukturës së zbulimit të talenteve më të mira në çdo klasë deri në vitin 2022 • Krijimi i planeve të personalizuara të performancës për të gjithë lojtarët e spikatur nga U-15 deri tek U-21 • Integrimi i plotë i shkencave sportive të cilësisë më të lartë dhe teknologjisë më të fundit te të gjitha ekipet kombëtare deri më 2025 • T'u sigurojmë të paktën një mundësi prove në ekipet kombëtare lojtarëve të shkollave në nivelin U-15, U-17 dhe U-19 çdo vit gjatë periudhës strategjike • Të sigurojmë që të gjithë trajnerët e ekipeve kombëtare A të kenë licencën UEFA PRO deri më 2022 dhe të gjithë trajnerët e ekipeve kombëtare të moshave (zv/trajner, trajnerët e ekipeve rajonale) të kenë licencën UEFA A brenda vitit 2022 • Të sigurojmë që çdo etapë e performancës të përfshijë planin e përshtatshëm psikologjik, ushqimor dhe fizik për lojtarët tanë
Përmirësimi i rregullores së licencimit të klubeve për të siguruar një mjedis ku futbollistët shqiptarë të mund të rriten	• Prezantimi i rregullave të reja për klubet që favorizojnë zhvillimin e talenteve deri në vitin 2023
Të sigurojmë të ardhmen afatgjatë të futbollit përmes zhvillimit proaktiv dhe njohjes së lojtarëve të rinj me futbollin ndërkombëtar	• Rritja e numrit të vendeve të lojtarëve në ekipet A të meshkujve dhe femrave për U-21
Të sigurojmë që të gjitha vajzat e talentuara të kenë mundësinë dhe mbështetjen për të përmbushur të gjithë potencialin e tyre në futboll	• Nëpërmjet përmirësimit të kushteve të licencimit, të prezantohen dhe të zbatohen programe stimuluese për klubet e femrave, duke siguruar përmes financimeve të FSHF-së zhvillimin e infrastrukturës së klubeve dhe përmirësimin e zhvillimit të talenteve deri në vitin 2022 • Implementimi i plotë i një programi kombëtar për zbulimin e vajzave të talentuara, i ngjashëm me programin aktual të meshkujve deri në vitin 2023 • Formimi i një ekipi kombëtar për femra U-15 deri në vitin 2023 • Të sigurojmë që 1 ekip femrash të kualifikohet në fazën e grupeve të • Ligës së Kampionëve për femra deri në vitin 2025

INFRASTRUKTURA

TË SIGUROJMË NJË MJEDIS LOJE TË SIGURT, TË ARRITSHËM DHE TË PËRBALLUESHEM PËR LOJTARËT E NIVELIT GRASSROOTS, DHE TË KEMI NJËINFRASTRUKTURË DHE STADIUME TË NIVELIT NDËRKOMBËTAR PËR ATA QË PERFORMOJNË NË NIVEL ELITAR.

INFRASTRUKTURA

PËRMBAJTJA

Gjatë 30 viteve të fundit, ne kemi qenë dëshmitarë të një transformimi në infrastrukturën sportive në të gjithë Shqipërinë. Ne vazhdojmë ndërgjegjësimin për nevojën e një infrastrukture më të madhe sportive në të gjithë vendin, duke parë zhvillimet e viteve të fundit. Loja e futbollit varet tërësisht nga niveli i fushave, të cilat janë jetike që lojtarët tanë të stërviten dhe të luajnë në të gjitha nivelet e lojës. Megjithatë, pavarësisht se kanë një rëndësi kaq të madhe, ne ende përballemi me një mungesë të konsiderueshme fushash, veçanërisht në lidhje me popullsinë tonë në Tiranë, si qendra jonë kryesore e aktivitetit të futbollit, ndaj presim me padurim të përdorim "Futbollin për Kombin 2025" si një mjet për ndryshimin e kësaj situate, për t'i ofruar çdokujt më shumë lehtësi për të luajtur lojën më të dashur të shqiptarëve.

Megjithëse kemi një vizion të qartë për zhvillimin infrastrukturor të futbollit në vend, vënia në zbatim e çdo plani do të kërkojë nivele të konsiderueshme planifikimi, angazhimi financiar dhe mbështetje nga palët e interesuara. Aktualisht, shumica e klubeve ka vetëm një fushë për stërvitje dhe për lojë dhe 90% e këtyre objekteve janë në pronësi të shtetit. Në këto kushte, mirëmbajtja e vazhdueshme e këtyre fushave ka qenë e vështirë të sigurohej, pasi burimet shtetërore shpesh orientohen diku tjetër, duke çuar në degradimin e shumë terreneve sportive dhe buxhete të reduktuara për përmirësime. Shumë prej fushave kanë ende nevojë për ndryshim thelbësor, dhoma zhveshjeje dhe parking makinash. Duke marrë parasysh këtë, faza e parë e çdo zhvillimi në këtë periudhë të re strategjike do të përfshijë një analizë intensive të hartës së të gjitha objekteve ekzistuese, për të kuptuar shkallën e mbulimit kombëtar, nivelin e cilësisë dhe buxhetin e përgjithshëm që nevojitet për mbështetje strukturore. Për ndërtimin e infrastrukturës për brezat e ardhshëm, prioriteti ynë do të jetë mbajtja e standardeve të larta të cilësisë, në mënyrë që këto objekte të shfrytëzohen nga mijëra lojtarë në vitet në vijim. Mbështetja e ofruar së fundmi në investimet e mëdha infrastrukturore, si rikonstruktimi i stadiumit "Loro Boriçi", "Elbasan Arena" dhe së fundmi stadiumi i Kukësit, "Zeqir Ymeri", të gjitha nisma të përbashkëta me qeverinë, tregojnë se bashkëpunimi i frytshëm arrin të japë efektin e duhur.

Përpara se të arrijmë nivelin e infrastrukturës së synuar, objektivi ynë kryesor në "Futbollin për Kombin 2025" do të jetë ndërtimi i të paktën 100 fushave, për të mbështetur pjesëmarrjen gjithnjë e më të madhe në nivel grassroots. Mundësia për të luajtur futboll, pavarësisht nga vendndodhja, mosha apo aftësia, duhet t'i ofrohet çdo qytetari shqiptar dhe ne shpresojmë që ndërtimi i këtyre fushave në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe qendrore, do të sigurojë rritjen e nevojshme dhe hedhjen e themeleve të qëndrueshme për lojën tonë.

Në nivel kombëtar, investimet në vitet e fundit kanë ndihmuar të dokumentojnë përkushtimin tonë për rritjen e futbollit dhe cilësisë së performancës në nivel ndërkombëtar nëpërmjet disa objekteve të nivelit europian. Në nëntor 2019 përfundoi stadiumi kombëtar "Air Albania" me kapacitet prej 22 000 vendesh, i ndjekur nga zhvillimet te "Qendra stërvitore kombëtare" dhe "Shtëpia e Futbollit". Si pjesë e "Futbollit për kombin 2025", vizioni ynë është që këto komplekse të bëhen të njohura si qendra edukative dhe zhvillimore, duke siguruar një mjedis të favorshëm për ekipet kombëtare, por gjithashtu dhe për grupet e interesit.

Përmes këtyre përpjekjeve në këtë fushë, ne jemi besimplotë që zhvillimet në infrastrukturë jo vetëm që do të inkurajojnë dhe do të mbështesin pjesëmarrjen, por gjithashtu do të rrisin numrin e spektatorëve falë kushteve që do të ofrojnë stadiumet tona. Pjesëmarrja e lartë sjell edhe mundësi më të mira për të rritur të ardhurat përmes bashkëpunimeve, që do të na sigurojnë më shumë liri dhe fleksibilitet në rritjen e infrastrukturës dhe plotësimin e nevojave të qytetarëve. Jemi të bindur se investimi në infrastrukturë, duke qenë një komponent kyç në punën tonë gjatë periudhës së ardhshme strategjike, do të ketë një impakt afatgjatë.

*TË DHËNAT E QERSHORIT 2021

37
FUSHAT ME BAR NATYRAL

26
FUSHAT ME BAR ARTIFICIAL

75+
FUSHAT E VOGLA NË SHKOLLA

1
QENDRA KOMBËTARE TË TRAJNIMIT

1
QENDRA TEKNIKE KOMBËTARE

1
STADIUM KOMBËTAR

22
STADIUMET KATEGORIA 1

9
STADIUMET KATEGORIA 2

0
STADIUMET KATEGORIA 3

3
STADIUMET KATEGORIA 4

INFRASTRUKTURA

FOKUSI YNË NË ZHVILLIMIN E INFRASTRUKTURËS NË FUTBOLLIN SHQIPTAR DO TË JENË INVESTIMET NË NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E FUSHAVE DHE AMBIENTEVE TË TJERA SPORTIVE, DUKE FILLUAR NGA NIVELI GRASSROOTS DERI NË FUTBOLLIN ELITAR.

KËTË DO TA ARRIJMË PËRMES PËRMBUSHJES SË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË MËPOSHTME:

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
Të sigurojmë që çdo qytetar shqiptar të ketë akses në një fushë futbolli të sigurt dhe të kënaqshme	• Auditimi i plotë për cilësinë dhe sasinë e fushave deri më 2022 • Ndërtimi i 100 fushave me bar natyral deri më 2025 • Ndërtimi i 10 fushave stërvitore me bar artificial deri më 2025 • Vendosja e të paktën 1 bashkëpunimi strategjik në vit për infrastrukturën
Zhvillimi i një rrjeti objektesh të nivelit europian për të frymëzuar lojtarët, trajnerët dhe stafin	• Përfundimi i punimeve në "Shtëpinë e futbollit" deri në vitin 2023 • Qendra sportive në Kamëz, duke përfshirë një kompleks akomodimi, dy fusha shtesë me bar dhe dy tribuna me një kapacitet prej 500 vendesh për t'u përdorur nga ekipet kombëtare të të gjitha moshave • Të rrisim prezencën tonë si organizatë në Qendrën Kombëtare Teknike (Shtëpia e futbollit), që kjo të bëhet e njohur në rang kombëtar si një vend për edukim dhe zhvillim në FSHF deri më 2022
Zhvillimi i cilësisë dhe aspekteve teknike të lojës për të përmirësuar përvojën për lojtarët dhe tifozët	• Ndërtimi i të paktën 10 fushave me bar artificial për Abissnet Superiore deri më 2024 dhe investime në ndriçimin dhe pjesën teknike të stadiumeve deri më 2022 • Të vazhdojmë të implementojmë dhe promovojmë një licensim të qartë dhe të konsoliduar për të gjitha klubet, duke siguruar që të gjitha stadiumet të jenë në përputhje me kriteret deri më 2025

FUTBOLLI I FEMRAVE

NE DO TË SIGUROJMË NJË LOJË TË HAPUR, TË AKSUESHME DHE QË TË JEP KENAQËSI, PËR TË GJITHA VAJZAT QË KANË DESHIRË PËR ANGAZHUAR ME FUTBOLL.

FUTBOLLI I FEMRAVE

PËRMBAJTJA

Rritja e futbollit të femrave ka qenë në fokusin e FSHF-së prej më shumë se 10 vjetësh. Nëpërmjet këtij investimi dhe përkushtimi të madh, futbolli i femrave në Shqipëri ka evoluar jashtëzakonisht shumë, duke ndërmarrë hapa të rëndësishëm veçanërisht në drejtim të infrastrukturës dhe duke ndryshuar pozitivisht perceptimin e publikut të gjerë. Përveç këtij dokumenti dhe progresit të treguar në këtë rubrikë të strategjisë, ne gjithashtu do të krijojmë strategjinë tonë të parë të futbollit për femra, si një simbol i angazhimit tonë të vazhdueshëm në këtë drejtim, të cilin do të kemi kënaqësinë ta ndajmë me të gjithë ju gjatë këtij viti si një vlerë të shtuar të "Futbollit për Kombin 2022-2025".

Duke u bazuar në një strukturë të ngjashme me atë të "Futbollit për Kombin 2022-2025", strategjia jonë e futbollit për femra do të përbëhet nga disa shtylla strategjike, duke ofruar vëmendjen e duhur dhe një angazhim të madh të burimeve njerëzore në fushat e mëposhtme:

- Pjesëmarrja
- Ekipet e elitës së futbollit për femra dhe ekipet kombëtare
- Edukimi & licencimi
- Marketingu, shikueshmëria dhe perceptimi

FSHF ndihet krenare për dëshirën dhe entuziazmin e treguar deri sot nga vajzat në mbarë vendin për të luajtur futboll dhe për përkushtimin e tyre për ta çuar futbollin e femrave në një tjetër nivel.

Për t'ia arritur këtij qëllimi, ne po ju prezantojmë objektivat e vizionit tonë për zhvillimin e futbollit të femrave që përfshihen në këtë rubrikë dhe në të gjithë dokumentin. Megjithatë, strategjia jonë e veçantë e futbollit për femra do të përmbajë detaje të mëtejshme. Në fokusin tonë do të jenë:

- Rritja e futbollit të femrave, duke shmangur pritshmëritë dhe krahasimet që lidhen me futbollin e meshkujve
- Zhvillimi i një marrëdhënieje të fortë me të gjithë pjesëmarrësit dhe klubet tona që angazhohen në futbollin e femrave
- Sigurimi i mbështetjes së një game të gjerë partnerësh të interesuar për një infrastrukturë të cilësisë së lartë për futbollin e femrave
- Sigurimi i angazhimit të duhur te futbolli i femrave në nivel elitar sa u përket klubeve të kategorisë superiore dhe mundësive të ofruara
- Kualifikimi i stafeve që punojnë me futbollin e femrave për të ofruar mjedise loje dhe stërvitjeje të cilësisë më të lartë
- Gjenerimi i të ardhurave të mëtejshme përmes partneriteteve të rëndësishme dhe marrëdhënieve me aktorë të tjerë për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme për futbollin e femrave

LOJTARE FEMRA PROFESIONISTE



EKIPET PJESËMARRËSE NË KAMPIONATIN KOMBËTAR TË FEMRAVE



U/18 LOJTARE FEMRA AMATORE





89
EKIPET PËR VAJZA TË MOSHAVE TË REJA

30
EKIPET RAJONALE

53
EKIPET E SHKOLLAVE U/13

FUTBOLLI I FEMRAVE

PËR TË ZHVILLUAR MË TEJ FUTBOLLIN E FEMRAVE, NE DO TË KRIJOJMË MJEDISE SA MË MIKPRITËSE DHE TË AKSESUESSHME, KU VAJZAT TONA TË MUND TË SHIJOJNË FUTBOLLIN DHE TË MUND TË SHPALOSIN POTENCIALIN E TYRE.

KËTË DO TA ARRIJMË PËRMES PËRMBUSHJES SË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË MËPOSHTME:

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
Zhvillimi dhe lançimi i një strategjie të re kombëtare për futbollin e femrave për të siguruar burime të posaçme dhe fokusin e duhur për këtë pjesë të futbollit	• Lançimi i një strategjie të re kombëtare për futbollin e femrave deri në pranverë 2023
Të sigurojmë që të gjitha gratë dhe vajzat shqiptare të kenë mundësinë të përjetojnë dhe shijojnë futbollin në mjedise cilësore dhe frymëzuese	• Ta shndërrojmë futbollin në sportin numër 1 për femra në Shqipëri • Dyfishimi i numrit të femrave që luajnë futboll dhe regjistrimi i së paku 4000 futbollisteve femra deri në vitin 2025 • Krijimi i 100 ekipeve të futbollit për femra U-15 – U-17 deri në vitin 2025 dhe vendosja e lidhjeve strukturore me klubet lokale • Krijimi i 60 ekipeve rajonale amatore për vajza të moshës U-13 deri në vitin 2025
Të ofrojmë arsimim me cilësi të lartë dhe mbështetje për të krijuar një rrjet gjithëpërfshirës, të mirëtrajnuar dhe të besueshëm të trajnereve, zyrtareve dhe administratoreve femra në të botën e futbollit shqiptar për femra	• Çdo ekip femrash në Shqipëri të ketë të paktën një trajnere femër deri në vitin 2025 • Të ofrojmë kurse të trajnimit dhe formimit zyrtar edhe brenda institucioneve arsimore, si për shembull në universitete, shkolla të mesme, etj. • Deri në vitin 2023 të sigurojmë që i gjithë arsimimi i trajnereve të femrave të jetë falas për kandidatet dhe të përmirësojmë aksesin në këto mundësi kualifikimi përmes ofrimit të kurseve verore • Të paktën 1 trajnere femër të jetë e përfshirë në mënyrë aktive në mbështetjen e çdo grupmoshe dhe ekipit kombëtar të femrave deri në vitin 2025 • Të zgjidhet të paktën 1 femër në Komitetin Ekzekutiv të FSHF-së deri në vitin 2025
Rritja e ndërgjegjësimit për futbollin e femrave në të gjithë Shqipërinë, duke thyer barrierat për pjesëmarrjen dhe duke siguruar që futbolli i femrave të jetë i aksesueshëm dhe frymëzues	• Të thyejmë barrierat kulturore përmes realizimit të 2 fushatave marketingu në vit për futbollin për femra në të gjitha kanalet e komunikimit • Të krijojmë dhe të lançojmë imazhe frymëzuese për ekipet kombëtare të femrave deri në vitin 2023, si edhe kampionatet e femrave dhe ndeshjeve të kupave deri në vitin 2024 • Të sigurojmë deri në vitin 2022 që çdo javë të transmetohet drejtpërdrejt të paktën 1 ndeshje e kampionatit elitë të femrave • Të arrijmë një marrëveshjeje transmetimi në nivel kombëtar për të gjitha kombëtaret e femrave dhe Kupën e Shqipërisë deri në vitin 2023
Të bëjmë të mundur që të gjitha gratë dhe vajzat e talentuara shqiptare të kenë mundësinë dhe mbështetjen për të shpërfaqur plotësisht potencialin e tyre në futboll	• Nëpërmjet kushteve të përmirësuara të licencimit, të nisë zbatimi i një programi incentivues për klubet e femrave, duke siguruar financimin e FSHF-së për zhvillimin e infrastrukturës së klubeve dhe për përmirësimin e zhvillimit të talenteve deri në vitin 2022 • Implementimi i plotë i një programi kombëtar për zbulimin e talenteve femra, i ngjashëm me programin aktual të meshkujve deri në vitin 2023 • Krijimi i një ekipi kombëtar për femra U-15 deri në vitin 2023 • Synimi i vendosur është që 1 ekip femrash të kualifikohet për në Ligën e Kampionëve të UEFA-s për femra deri në vitin 2025

QEVERISJA E MIRË



FUNKSIONIMI SI NJË ORGANIZATË TRANSPARENTE, E MIRËSTRUKTURUAR DHE E QËNDRUESHME

QEVERISJA E MIRË

PËRMBAJTJA

Ne jemi të vetëdijshëm se ofrimi i mundësive dhe i një mjedisi më të mirë për futbollin varet nga integriteti dhe efikasiteti i FSHF-së si organizatë. Nga komiteti ekzekutiv e deri te stafi ynë stërvitor në fushë, çdo individ në organizatë ka përgjegjësinë e përbashkët për të punuar në mënyrën e duhur, për të zhvilluar dhe ofruar lojën që të gjithë e duam.

Qeverisja e mirë siguron themelet e duhura për misionin tonë për futbollin. Sigurimi i kapaciteteve dhe i përvojës së duhur për pozicionet kyçe, apo edhe angazhimi i rregullt me një sërë partnerësh për të dëgjuar zërin e vërtetë të futbollit shqiptar, janë disa shembuj praktikash të mira që ne shpresojmë t'i rrënjosim në të gjitha nivelet e lojës. Nëpërmjet zbatimit të kësaj qasjeje, ne e dimë se mund të arrijmë në nivele më të larta efikasiteti dhe eksperience për ta çuar futbollin shqiptar në një tjetër nivel.

Pjesë e "Futbollit për Kombin 2025" do të jetë edhe angazhimi i përbashkët në rrënjosjen e parimeve të qeverisjes së mirë gjatë punës sonë të përditshme, gjë që do të na mundësojë të arrijmë aspiratat tona strategjike, jo vetëm në nivelin e futbollit të bazës dhe kualifikimit, por edhe në zhvillimin e ekipeve tona kombëtare dhe infrastrukturës sportive.

20
SEKTORET MBËSHTETËS NË FSHF

9
DEPARTAMENTET E FSHF

112
STAFI I PËRHERSHËM I FSHF

11
ANËTARËT E KOMITETIT EKZEKUTIV, PËRFSHIRË PRESIDENTIN

12
KOMISIONE/ KOMITETE

1
MBLEDHJE TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

4
TAKIMET E KOMITETIT EKZEKUTIV CDO VIT (MINIMUM)

QEVERISJA E MIRË

QEVERISJA E MIRË ËSHTË PJESA MË E RËNDËSISHME NË ÇDO GJË QË NE BËJMË, DHE NË VIJIM NE DO TË PERPIQEMI TË JEMI GJITHMONË NJË HAP PËRPARA DHE NË LINJË ME PRAKTIKAT MË TË MIRA NDËRKOMBËTARE NË QEVERISJEN E FUTBOLLIT.

KËTË DO TA ARRIJMË PËRMES PËRMBUSHJES SË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË MËPOSHTME:

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
Të jemi të ndershëm, transparentë dhe të angazhuar për krijimin e mjedisit më të mirë të mundshëm për futbollin në Shqipëri	• Duke u bazuar te 10 parimet e qeverisjes së UEFA-s, të nisim dhe të implementojmë një strategji të FSHF-së për qeverisjen e mirë deri më 2023 • Të rishikojmë strukturën e komiteteve që ekzistojnë në FSHF për të pasur diversitet dhe barazi. Në këtë kuadër, do të krijohen minimumi 3 komitete për të rritur futbollin deri më 2023 • Të krijojmë platforma digjitale dhe kanale komunikimi si mekanizma për të përfshirë dhe kualifikuar stafin e FSHF-së dhe të gjitha grupet e interesit në futbollin shqiptar
Të kemi një qasje efektive dhe të përshtatshme për të siguruar që FSHF të përdorë teknologjinë më të fundit për të pasur rezultate dhe efikasitet	• Të përdorim teknologjinë përkatëse për të bërë të mundur që FSHF të përfaqësojë një organizatë me performancë të lartë dhe që udhëhiqet nga novacionet më të fundit deri në vitin 2025 • Të finalizojmë zbatimin e një sistemi të avancuar ERP për të mbështetur funksionet administrative deri në vitin 2022 • Të vendosim një lidhje të përbashkët për të gjitha veprimet operacionale të FSHF-së deri në vitin 2023
Të rrisim vazhdimisht aftësitë dhe kapacitetet e FSHF-së nëpërmjet zhvillimit dhe implementimit të mundësive organizative për zhvillim personal	• Të mbështesim pajisjen e 25 individëve të FSHF-së me Certifikatën në Menaxhim Futbolli deri në vitin 2025 • Të sigurojmë që i gjithë stafi i FSHF-së të ndërmarrë të paktën 1 përvojë trajnimi dhe kualifikimi në vit • Të krijojmë një program për praktikantë në FSHF që ofron të paktën 3 mundësi në vit nga viti 2022
Të punojmë me UEFA-n dhe partnerë të tjerë strategjikë për të rritur eksperiencën dhe aftësitë organizative të FSHF-së	• Të jemi në kontakt me partnerët tanë në UEFA Grow çdo muaj për të qëndruar të informuar rreth mundësive të zhvillimit që ofrohen • Të eksplorojmë zhvillimin komercial si një projekt pilot me UEFA-n për të integruar praktikat, sistemet dhe proceset më të mira deri në vitin 2022

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

MARRËDHËNIA ME GRUPET E INTERESIT DHE KOMUNIKIMI EFEKTIV I PUNËS SONË

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

PËRMBAJTJA

Duke qenë se ndeshjet ndërkombëtare të futbollit janë të shpeshta, është detyra jonë që të informojmë dhe të përditësojmë vazhdimisht qytetarët me të rejat dhe mundësitë që ofron futbolli. Çdo ditë, individë në të gjithë Shqipërinë luajnë, shikojnë ose diskutojnë për futbollin dhe FSHF mund të ketë një rol kyç në mbështetjen e cilësisë së këtij angazhimi nëpërmjet promovimit të eventeve dhe shpërndarjes së informacionit.

Ka një sërë arsyesh përse futbolli luhet, ndiqet dhe diskutohet çdo ditë, në të gjithë vendin, por shumica e arsyeve janë personale. Qoftë prej pasionit për klubet e zemrës apo kënaqësisë që të fal shënimi i një goli, roli ynë si FSHF është të komunikojmë sa më mirë me palët e përfshira në nivel individual. Është detyra jonë të ofrojmë dhe të promovojmë mundësi për angazhim dhe diskutim, në mënyrë që futbolli të vazhdojë të jetë sporti numër 1 në Shqipëri.

Për t'ia arritur këtij qëllimi, ne duhet të përshtatim mënyrën e komunikimit dhe të përdorim një sërë kanalesh për të përçuar mesazhet tona, ndonëse e dimë se nuk mund të jemi të suksesshëm duke qenë vetëm. Puna me partnerët më në zë të medias dhe individë të afërt në të gjithë rrjetin e futbollit do të jetë thelbësore për të siguruar që zëri ynë të dëgjohet.

Përmes kësaj qasjeje bashkëpunuese dhe të koordinuar, puna jonë në këtë fushë do të udhëhiqet nga cilësia e informacionit që ne shpërndajmë, por edhe e metodës me të cilën komunikojmë me publikun.

Ne do të bëjmë të mundur që FSHF të jetë në sytë e publikut një organizatë e besueshme dhe një burim njohurish, përditësimesh dhe mundësish për gjithçka që ka të bëjnë me futbollin në Shqipëri.

RRITJA NË ASPEKTIN DIGJITAL ARRITJE E FSHF

FACEBOOK

NDJEKËSIT E FAQES TË DHËNAT PËR JANAR - SHTATOR 2021	**1,990**
TOTALI I NDJEKËSVE TË FAQES	**195,380**
NDJEKËSIT E FAQES	**8,891**
PËLQIMET E FAQES 4 JANAR	**190,378**
PËLQIMET E FAQES 28 SHTATOR - +2,989 VS 4 JANAR	**193,367**
ARRITJET E POSTIMEVE	**1,837,902**
ANGAZHIMET E POSTIMEE	**1,836,902**

INSTAGRAM

LLOGARITË E ARRITURA

TË DHËNAT NGA 10 KORRIK NË 10 TETOR 2021
(PERIUDHA 3 MUJORE)

LLOGARITË E ARRITURA +67,9% VS 10 PRILL - 10 KORRIK	**539,806**
PËRSHTYPJET +36.2% VS 10 PRILL - 10 KORRIK	**14,148,727**
KLIKIMET E FAQES +48.1% VS 10 PRILL - 10 KORRIK	**5,619**
VIZITAT E PROFILIT +103% VS 10 PRILL - 10 KORRIK	**487,968**
KLIKIME TË ORIENTUARA +23.3% VS VS A10 PRILL - 10 KORRIK	**74**
KLIKIME TË BUTONIT TË THIRRJES +280% VS 10 PRILL - 10 KORRIK	**240**

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

PËR TË RRITUR MË TEJ NIVELIN E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, NE DO TË JEMI TË DREJTËPËRDREJTË DHE TË KUJDESSHËM NË DHËNIEN E INFORMACIONEVE DHE MESAZHEVE TË DUHURA, PËR TA BËRË FSHF-NË BURIMIN MË TË SIGURT TË MARRJES SË INFORMACIONIT NË LIDHJE ME FUTBOLLIN.

KËTË DO TA ARRIJMË PËRMES PËRMBUSHJES SË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË MËPOSHTME:

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
Të ofrojmë mbështetje të madhe për partnerët tanë kryesorë dhe palët e interesuara për të gjitha çështjet e futbollit	• Të zhvillojmë dhe të zbatojmë çdo vit një plan gjithëpërfshirës për menaxhimin e palëve të interesuara për të siguruar që FSHF të ofrojë shërbimin dhe mbështetjen më të mirë për familjen e saj të madhe të futbollit
Të konsolidojmë përpjekjet tona për rritjen e lojës së futbollit për meshkuj dhe femra përmes zhvillimit dhe promovimit të komunikimit bindës, novator dhe raporteve të ndikimit	• Të përdorim të gjitha kanalet e komunikimit fizik dhe digjital për të thyer barrierat që pengojnë pjesëmarrjen, veçanërisht për vajzat e reja • Të rrisim me 10% numrin e vajzave të reja që dëshirojnë ta ushtrojnë këtë sport • Të hartojmë çdo vit raporte të ndikimit duke përdorur raste studimore dhe histori personale për të dëshmuar ndikimin social të FSHF-së për kontributin e saj si në shëndetin fizik, ashtu edhe në atë mendor
Të koordinojmë aktivitetin tonë të komunikimit për të rritur futbollin në mbarë vendin	• Të zhvillojmë dhe të lançojmë një bazë të dhënash për mundësitë e futbollit të bazës dhe atij amator deri në vitin 2023 • Të lançojmë një strategji për edukimin e prindërve deri në vitin 2023 • Të lançojmë një kalendar për ngjarjet e futbollit shqiptar deri në vitin 2022 • Të organizojmë 5 kurse komunikimi në vit për individët në klube • Të organizojmë 5 fushata edukative dhe ndërgjegjësimi social në vit

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

INFORMIMI PËR ROLIN E FSHF-SË NË ZHVILLIMIN E SHOQËRISË SHQIPTARE

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

PËRMBAJTJA

Aktivitetet e përditshme të FSHF-së shkojnë përtej mbështetjes së ekipeve kombëtare dhe i gjithë stafi krenohet me rolin e tyre gjithëpërfshirës dhe aftësinë për të ndikuar pozitivisht në shoqëri nëpërmjet fuqisë së futbollit. Për të realizuar vizionin tonë për të qenë "një forcë shtytëse pozitive në botën sportive dhe shoqërore në të gjithë Shqipërinë, duke përdorur futbollin për të maksimizuar potencialin", ne nuk jemi vetëm në aktivitetet tona dhe një bashkëpunim më i madh me aktorët tanë kryesorë si pjesë e "Futbollit për Kombin 2025" do të jetë vendimtar për suksesin tonë strategjik.

Sa i përket punës sonë në marrëdhëniet me publikun - qoftë nëse jemi duke bashkëpunuar në një nivel individual, si me lojtarët, trajnerët dhe prindërit, ose në një nivel organizativ, si me qeverinë, shkollat ose organizatat private në të gjithë sportin - FSHF është e përkushtuar të tregojë një qasje më proaktive ndaj aktivitetit të saj të komunikimit, me fokus ndërgjegjësimin jo vetëm për mënyrat se si FSHF po rritet dhe po e zhvillon futbollin në mbarë vendin, por edhe se si kjo po ndikon pozitivisht në jetën e njerëzve në gjithë Shqipërinë.

Për të dhënë disa shembuj, FSHF do të përpiqet:

• Të rrisë ndërgjegjësimin për mënyrën se si FSHF mbështet trajnerët e futbollit në shkolla dhe për të mirat që vijnë falë kësaj mbështetjeje
• Të dëshmojë se si FSHF mbështet objektivat e qeverisë për rritjen ekonomike dhe krijimin e një kombi të shëndetshëm dhe aktiv
• Të ndryshojë perceptimin për futbollin e femrave mes prindërve dhe lojtarëve, duke e pozicionuar atë si një sport që u mundëson vajzave të reja të kenë më shumë vetëbesim, të kenë një mënyrë jetese aktive e të shëndetshme, të takojnë miq të rinj dhe të shoqërohen në një mjedis të sigurt. Gjithashtu, të mësojnë aftësi të reja, të tilla si puna në grup dhe lidershipi, nga të cilat do të përfitojnë në të ardhmen.

Shkalla e suksesit tonë do të varet nga aftësia jonë për ndërgjegjësimin rreth ndikimit të futbollit në të gjithë vendin dhe ne shpresojmë që të përparojmë në këtë fushë. Këtë do ta arrijmë jo vetëm nëpërmjet menaxhimit efektiv të komunikimit brenda vendit, por edhe përmes punës në partneritet me organizatat, duke qenë të vetëdijshëm se po kontribuojmë për formimin e një kombi futbolldashës më të fortë, që mbështetet nga një shoqëri më e fortë shqiptare.

PËRGJIGJET E MARR NGA ANKETIMI NË LIDHJE ME EFEKTIN SOCIAL TË SPORTIT/FUTBOLLIT DHE PUNEN E FSHF - STUDIM I VITIT 2020



% E POPULLSISË
QË MENDON QË FSHF KA
NJË IMAZH POZITIV



% E POPULLSISË QË BESON SE FSHF
ËSHTË NJË ORGANIZATË
E SUKSESSHME

SHQIPËRIA
PERIUDHA: 2020

IMPAKTI NË SHOQERI

£9,960M

Ndikimi ekonomik i përfitime sociale

ARSIMI & PUNËSIMI
£1.20 MILION

PROJEKTET & PROGRAMET
£8.74 MILION

IMPAKTI NË EKONOMI

£25,121M

Kontributet direkte ndaj ekonomisë

VLERA E DREJTËPËDREJTË
£5.15 MILIONË

SHPENZIME PËR LOJTARËT
£19.97 MILION

PUNËSIMI
£2.88 MIJË

IMPAKTI NË SHËNDET

£10,089M

Kursimet për kujdesit shëndetësor nga angazhimi me futboll

CVD & DIABETI
£243.48 MIJË

SHENDETI MENDOR
£102.08 MIJË

LËNDIMET
-£393.42 MIJË

PROJEKTET & PROGRAMET
£4.31 MILION

MIRËQENIA NË TOTAL
£5.81 MILION

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

PËR T'U SIGURUAR QË PO I SHTOJMË VLERA POZITIVE SHOQËRISË, NE DO TË PËRDORIM FUQINË E FUTBOLLIT PËR TË RRITUR CILESINË E JETËS SË CDO SHQIPTARI.

KËTË DO TA ARRIJMË PËRMES PËRMBUSHJES SË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË MËPOSHTME:

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
Të japim rregullisht informacion rreth aktivitetit të FSHF-së dhe të dëshmojmë progresin që po bëjmë për t'u kthyer në një federatë futbolli përparimtare	• Të bashkëpunojmë me institucionet kryesore dhe politikëbërësit në të gjithë Shqipërinë për të pozicionuar FSHF-në si një organizatë lider që mbështet zhvillimin e vendit, duke vlerësuar klubet e FSHF-së si aktorë kryesorë që mund të ndihmojnë në formimin dhe zbatimin e objektivave në nivel komunitar • Të arrijmë një rritje prej 5% në numrin e njerëzve që e shohin FSHF-në si një organizatë të suksesshme dhe të përqendruar në përgjegjësinë sociale deri në vitin 2025
Të promovojmë dhe të komunikojmë vazhdimisht një qasje shoqërore ndaj punës sonë dhe ndikimit pozitiv social që ne ofrojmë	• Të nisim Fondacionin FSHF deri në vitin 2023 për të prezantuar dhe promovuar punën bamirëse dhe ndikimin tonë në të gjithë vendin • Të hapim Shkollën e Futbollit FSHF deri në vitin 2023 për të lidhur arsimin dhe përvojën e futbollit për talentet tona të së nesërmes dhe për ata fëmijë që duan të specializohen në futboll • Të hartojmë çdo vit një raport ndikimi për realizimin e strategjisë sonë të komunikimit dhe për ndikimin e saj në rritjen e futbollit shqiptar
Të sigurojmë që FSHF të jetë proaktive në ofrimin e programeve që kontribuojnë qartazi në përmirësimin e përgjithshëm të shoqërisë	• Të konsultohemi çdo dy vjet me aktorët kryesorë për të ndihmuar në formimin e aktivitetit të FSHF-së • Të zhvillojmë dhe të zbatojmë një fushatë marketingu specifike për shkollën me rezultate me karakter social, për të mbështetur punën e shkollës sonë deri në vitin 2022 • Të realizojmë të paktën 1 projekt social në vit nga viti 2022
Të promovojmë përfitimet e punës vullnetare në futboll dhe vetëpërmbushjen që mund të sjellë kjo gjë	• Të organizojmë një konferencë vjetore të vullnetarëve të FSHF-së nga viti 2022 • Të nisim serinë e FSHF-së për vullnetarë "Përfshihuni në futboll" deri në vitin 2023

PËRMBYLLJE

PËRMES FUTBOLLIT PËR KOMBIN 2025, NE JEMI ENTUZIASTË PËR TË ARDHMEN E FUTBOLLIT SHQIPTAR DHE SHOQËRISË SHQIPTARE, DHE DUHET TË FALËNDEROJMË LOJTARËT, TRAJNERËT, STAFIN DHE PARTNERËT PËR KONTRIBUTIN E TYRE NË KRIJIMIN E KËSAJ STRATEGJIE.

Ne jemi të vetëdijshëm se puna e vërtetë fillon në realizimin dhe zbatimin e planeve të përcaktuara në këtë dokument, megjithatë, përmes këtyre përpjekjeve, ne e dimë se çdo qytetar në mbarë vendin mund të përfitojë nga progresi që do të bëjmë në të gjitha këto fusha me qëllimet që kemi vendosur.

Futbolli është më shumë se një lojë për të gjithë ne në FSHF, është më shumë se thjesht një punë: është një mënyrë jetese dhe një mjet me vlerë që ne e dimë se mund të ndërtojë një shoqëri më të mirë, dhe për këtë arsye, ne mezi presim të punojmë me të gjithë ju si pjesë e këtij kapitulli të ri strategjik.

GRASSROOTS

EDUKIMI

KOMPETICIONET KOMBËTARE

EKIPET KOMBËTARE

INFRASTRUKTURA

FUTBOLLI I FEMRAVE

QEVERISJA E MIRË

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

FUTBOLLI PËR KOMBIN

2022-2025